

Dorëshkrimet e hadithit, në bibliotekat publike të Shqipërisë

Sulejman Osmani

Abstrakti

Hulumtimi për librat e Hadithit në mektebet shqiptare, nuk ka për synim vetëm zbulimin e kontributit të shqiptarëve në këtë fushë, por edhe zbulimin e një thesari të çmuar të trashëgimisë Islame në përgjithësi, pasi ummeti Islam është një trup në kulturën, identitetin dhe përkatësinë e tij. Ky fakt duhet të na bëjë edhe më të përgjegjshëm për obligimet që kemi ndaj trashëgimisë sonë Islame. Në këtë mënyrë zbulojmë identitetin tonë, i cili për shkak të shumë faktorëve ka mbetur i papublikuar.

Fjalë kyçe: Hadith, dorëshkrimet, libri, Shqipëri, kultura, identitet

Përmbledhje

Prania e dorëshkrimeve me alfabet arab në Shqipëri¹ nuk është diçka që duhet të na shkaktojë ndonjë habi, kjo për faktin se kemi të bëjmë me territore ku muslimanët jetojnë prej shekujsh tashmë. Trojet shqiptare kanë qenë nën administrimin e Perandorisë Osmane dhe, sipas dokumenteve historike, gjuha arabe ka qenë gjuha zyrtare e shkrimit, sikur se ka qenë e detyrueshme në kurikulat mësimore, pastaj shumë nga mësuesit e këtyre shkollave, ishin edhe hoxhallarë.

1 Në këtë punim kemi për qëllim hulumtimin e dorëshkrimeve me alfabet arab që kanë të bëjnë me lëmin e Hadithit dhe Shkencave të tij që gjendet në Bibliotekën Kombëtare Shqiptare në Tiranë dhe Arkivit Qendror të Shtetit në Tiranë.

Nuk ka dyshim se me ardhjen e Perandorisë Osmane, erdhi libri, kultura, dhe feja Islame. Në ato periudha të mëhershme libri shkruhej, kopjohej dhe shpërndajej. Duke qenë se gjuha arab është gjuha e Kur'anit, në kohë të mëhershme, asaj i është kushtuar rëndësi e veçantë, dhe për të thënë të vërtetën, personalisht këtë fakt, kam arritur ta kuptoj edhe më mirë kur bëra këtë hulumtim.

Koha po dëshmon se të parët tanë ishin pronarë të mektebeve të shumta. Kështu i shërbyen diturisë duke u vënë në shërbim të shkencës dhe duke shpërndarë librin. Me rënien e Perandorisë Osmane, gjendja do të përshkallëzohet për keq dhe vendi do të pushtohet me ide kundër fesë dhe besimit. Dritaret, nëpër të cilat myslimanët shikonin dijen dhe shkencën, do të mbyllen ndërsa feja do të dobësohej shumë. Kjo do të arrinte pikën më të lartë, kur pushteti do të kalonte në duart e komunistëve, që, për çudinë e botës mbarë, Shqipërinë do ta shndërronë në shtetin e parë ateist në botë. Kjo do të shkaktojë ndalimin zyrtar të fesë, gjë që do të ndikojë edhe në kulturën e shkrimit. Feja shihej si pengesë, e cila duhej zhdukur sa më parë të ishte e mundur. Në Shqipëri ka një numër të konsiderueshme të dorëshkrimeve me alfabet arab të cilat janë ruajtur në institucionet shtetërore dhe sot është e mundur të kemi qasje në to. Ato përfaqësojnë gati të gjitha shkencat Islame, madje edhe një numër i tyre bie në lëmin e ngushtë të Hadithit dhe shkencave të tij, të cilat i kemi paraqitur në këtë hulumtim.

Libri Islam dhe sfidat e kohës

Hulumtimi për dorëshkrimet me alfabet arab, në mektebet në Shqipëri ndoshta dallon nga hulumtimi në mektebet diku tjetër, kjo për shkak të disa specifikave nëpër të cilat ka kaluar ky vend dhe periudhës së gjatë të sundimit të komunizmit, i cili në Shqipëri ishte shumë i egër, pa dyshim që hulumtuesi qartazi i vë re gjatë punës së tij. Më konkretisht, periudhat nëpër të cilat ka kaluar ky popull, e që kanë qenë të shoqëruara me zhvillime nga më të ndryshmet, kanë pasur për pasojë ndryshime të mëdha që kanë prekur fusha të ndryshme. Sigurisht që në këtë aspekt më së shumti është goditur fusha fetare, Islame. Komunizmi, që pothuajse gjatë tërë shekullit XX sundoi në këto troje, ka dëmtuar aspektin fetar islam më shumë se çdo gjë tjetër, si në anën ideore po ashtu edhe në atë praktike.

Në parim, ne punonjësit e fushës së islamistikës duhet të jemi përgjegjës për të hulumtuar trashëgiminë tonë Islame. Ky motiv më shtyri të interesohem, e më pas të hulumtoj dorëshkrimet në fushën e Hadithit dhe Sunetit si një kategori specifike, sepse kanë të bëjnë ngushtë me Muhamedin a.s., thëniet e tij, jetën dhe veprën e tij. Pushteti ateist e kishte klasifikuar Shqipërinë në listën e shteteve të harruara, duke dashur që ta zhveshin përgjithmonë nga identiteti Islam. Kësisoj,

në këtë klimë dhe atmosferë, ka qenë e vështirë të ofrohet diçka konkrete në shërbim të njohjes të trashëgimisë së shkruar Islame. Nga një aspekt tjetër, historia Islame, që shtrihet përgjatë shekujve, imponon veten si faktor, pavarësisht rrethanave, sepse Allahu është Ai që ka marrë përsipër ruajtjen e fesë së Tij, si gjithkund tjetër, po ashtu edhe në këto troje.

Allahu thotë: *Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kur'anin dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij.* (El-Hixhr, 9)

Qëllimi i hulumtimit në këto mektebe

Nuk ka dyshim se një kontribut shumë i çmuar dhe me vlera të veçanta është hulumtimi i dorëshkrimeve Islame, e në këtë rast atyre të Hadithit të cilat lidhen me lëmin e ngushtë të Muhamedit a.s. dhe shikuar nga ky aspekt, Hadithi përfaqëson burimin e dytë të Islamit, andaj kontributet e tilla klasifikohen si njohuri suplementare dhe plotësojnë literaturën burimore të bazuar në trashëgiminë dhe kulturën tonë Islame. Mendoj se hulumtimi i dorëshkrimeve me alfabet arab te ne, ende paraqet një risi, sepse shikuar nga shumë aspekte është fushë e panjohur dhe deri tani janë bërë shumë pak gjurmime në këtë aspekt.

Të gjithë ata që përcaktohen për hulumtimin e kësaj fushe ballafaqohen me probleme të shumta si ato të natyrës profesionale e po ashtu edhe ato burokratike. E para ka të bëjë me natyrën e dorëshkrimeve sepse siç është gjendja e tyre dhe kushtet në të cilat janë ruajtur, vështirësitë që hasen me rastin e leximit të tekstit të shkruar e kështu me radhë. E dyta ka të bëjë me rregullat e vendosura nga përgjegjësit e mektebeve, të cilat krijojnë pengesa të shumta në rrugën e arritjes deri te dorëshkrimi i dëshiruar.

A ka dorëshkrime Islame në Shqipëri?

Ndoshta i pari që në botën Islame hoqi vellon e cila kishte mbuluar dorëshkrimet me alfabet arab, e që gjenden në Shqipëri, është studiuesi i mirënjohur Mahmud Abdul Kadir Arnauti, i cili në vitin 1993 vizitoi Shqipërinë, dhe duke qenë se ishte i njohur për pasionin e tij të madh për librin, praninë e tij në Tiranë e shfrytëzoi për të vizituar edhe Bibliotekën Kombëtare, ku hulumtoi për libra të trashëgimisë Islame, të shkruara dhe të publikuara apo edhe të atyre që gjendeshin në dorëshkrime. Nuk i ra të hulumtonte dhe aq gjatë, derisa u befasua me tituj që as nuk kishte ëndërruar t'i gjente. Si produkt, përpiloi një listë me titujt e dorëshkrimeve me alfabet arab, të klasifikuar sipas tematikave, sigurisht duke mos harruar këtu edhe

ato të Hadithit. Ai nuk është marrë shumë me radhitjen e tyre apo nëndarjen brenda fushave përkatëse. Ai këtë doracak, në gjuhën arabe, e emërtoi: *Mahtutatun aslijeh fi Albanija* “Dorëshkrime origjinale në Shqipëri” ndërsa për hulumtimin e tij në Bibliotekën Kombëtare në Tiranë dhe qëllimin shprehet: “*Zakonisht në dorë më binin libra arabë dhe osmanë të botuara në Stamboll, Kajro, Bejrut, ndërsa më pak libra në persisht. Nga tërësia e dorëshkrimeve arabe që më kanë rënë në dorë, nga ajo që përmban kjo bibliotekë në Tiranë, kam nxjerrë këtë listë që përmban ky libërth, që t’i njoftoj hulumtuesit dhe të interesuarit për dorëshkrimet arabe në Siri, vendet arabe dhe vendet tjera të ndryshme, për dorëshkrimet e thesarit islam që përmban Shqipëria, e që janë të rëndësishme dhe me vlerë për çdo musliman dhe për të gjithë ata që, për një ose shkak tjetër, kanë lidhje me qytetërimin arabo-islam.*”²

Titujt e librave i ka radhitur sipas renditjes së alfabetit arab, ndërsa është munduar që të japi shpjegime sa më të detajuara për dorëshkrimin. Nuk ka pretenduar asnjëherë se ka përfshirë të gjitha dorëshkrimet që gjenden në këtë mektebe, por është munduar që të bëjë më të mirën, duke dashur që lexuesit arab t’ia ofrojë në një mënyrë sa më të mirë dhe saktë të mundshme...

Më pas, ky doracak, është publikuar si një udhëzues, bibliografi ose indeks, i cili është prezantuar në panairë të shumta, e që tek vizitorët ka shfaqur interesim të madh. Në këtë kontekst, Ali Ekber Dija thotë: “*Bibliografia e dorëshkrimeve arabe në Bibliotekën Kombëtare në Tiranë më la shumë përshtypje, sepse, një studiuesi arab nuk mund t’i ketë shkuar ndërmend se në një shtet evropian në bregdet të Adriatikut mund të ketë dorëshkrime arabe apo persiane. E lexova përmbajtjen dalëngadalë. U binda se në atë bibliotekë gjendet një thesar i çmuar, të cilën e mohonin, apo e injoronin studiuesi e lindjes në kohën moderne.*”³

I ngazëllyer me përmbajtjen e bibliografisë, ai flet për motivimin gjithnjë e më shumë prej saj: “*...ndoshta do të zbuloj diç të re dhe për herë të parë për vendin tim.*” Ndërsa duke vlerësuar këtë punë thotë: “*Profesor Mahmud Arnauti ka përgatitur një bibliografi të vogël, e cila meriton çdo respekt dhe vlerësim, për shkak se na ka hapur sytë që ta shohim Shqipërinë e bukur nëpërmjet kësaj dritareje të vogël.*”⁴

Karakteristikë e kësaj bibliografi është se përmban libra të fushave të ndryshme Islame, një numër jo i vogël i të cilave kanë të bëjnë me Hadithin.⁵

2 Mahmud Abdul Kadir el-Arnaut, *Mahtuat aslijeh fi Albanija* (Liban: Dar el-fikr, 1993), fq. 9. (fletushkë e pa botuar, pa shënime të tjera) Autori është i biri i dijetarit të mirënjohur Abdulkadër Arnauti. Mahmudi ishte më i madhi nga djemtë e tij. I rritur në Damask ku bëri edhe karrierën shkencore. Me fillimin e luftës në Siri, më gjithë familjen e tij, erdhi të jetojë në Kosovë ku punoi si lektor në Fakultetin e Studimeve Islame. Vdiq në Prishtinë në ditë Ramazani me 05 qershor 2017. Pas vetes la një trashëgimi të shkruar me shumë tituj librash dhe hulumtime nga më të ndryshmet me theks të veçantë në fushën e hadithit dhe historisë Islame.

3 Ali Ekber Dija, “Shëtitje në hapësirat e Bibliotekës Kombëtare në Shqipëri”, revista Perla, nr. 4, Tiranë (1996), fq. 30.

4 Dija, “Shëtitje në hapësirat e Bibliotekës Kombëtare në Shqipëri”, Perla, fq. 31.

5 Më shumë detaje do të sjellim kur të flasim për dorëshkrimet e Hadithit në Bibliotekën Kombëtare në Tiranë.

Bibliografia është botuar në gjuhën arabe, me disa shënime të rëndësishme, ndërsa është përkthyer edhe në shqip.

A gjendet ndonjë indeks i dorëshkrimeve të Bibliotekës Kombëtare në Tiranë?

Puna e Profesor Mahmudit ka qenë një nismë e mbarë për ata që do ta pasojnë në punën e dorëshkrimeve. Pas vetëm pesë viteve, Instituti i Trashëgimisë Islame El-Furkan, do të filloj hulumtimin për trashëgiminë e të parëve, duke dërguar në Tiranë një ekip të përbërë nga hulumtues dhe studiues, puna e të cilëve ka qenë të merren me këto dorëshkrime. Ata bënë një punë të shkëlqyer, dhe, me gjithë vështirësitë në të cilat hasen, na ofruan një vëllim të rrallë sa i përket dorëshkrimeve në fjalë.⁶

Çfarë e motivoi Furkanin të merret me këtë projekt?

Ekipi i studiuesve të përmendur, qysh në fillim të librit, shpalosin qëllimin dhe arsyen përse u morën me këtë projekt. “*Shqipëria ka qenë prej atyre vendeve, që për shkak të rënies së regjimit komunist, ka kaluar nëpër etapa shumë të vështira. Myslimanët, ndonëse janë shumica e popullatës, i janë ekspozuar shfarosjes: xhamitë e tyre janë shkatërruar, ndërsa është bërë përpjekje për të shkëputur tërësisht gjeneratat e reja nga rrënjë e tyre Islame. Në këtë kontekst, nuk është larg mendsh që edhe trashëgimia e tyre t’i jetë ekspozuar anashkalimit dhe shkatërrimit. Nëse kësaj i shtojmë edhe faktin se kjo trashëgimi nuk është regjistruar fare, ashtu siç mund të mësohet qartë nga indeksi i publikuar nga Instituti El-Furkan për dorëshkrimet Islame në botë, atëherë mund ta paramendojmë rrezikun që ka kërcënuar kujtesën e këtyre popujve. Pikërisht për këtë gjë, Instituti ka filluar të mbledhë dorëshkrimet Islame në Tiranë, për çka, më 1995, ka dërguar një ekspert të tij në Tiranë për të vizituar Bibliotekën Kombëtare dhe Arkivin Shtetëror, si kryeqendra të dorëshkrimeve shqiptare. Instituti është përpjekur të koordinohet me përvojat kombëtare për të regjistruar këto dorëshkrime, por mungesa e ekspertëve ka pamundësuar realizimin e këtij qëllimi, për çka, Instituti është detyruar të hulumtojë për një zgjidhje alternative.*”⁷

6 Abdu-s-Settar El-Haluxhi dhe Habibullah Adhami, *Fehres el-mabrutat el-islamijeh bi-l-mektebeti-l-vatanijeti el-albanijeh fi Tirana* (Londër: Muessese el-Furkan li et-turath, 1997), Publikimi 28.

7 Adhami, *Fehres el-mabrutat el-islamijeh bi-l-mektebeti-l-vatanijeti el-albanijeh fi Tirana*, Elif (I) (fjala e Ahmed Zeki Jemanit me rastin e botimit).

Metoda e tyre në punimin e librit

Të angazhuarit në këtë projekt, kanë bërë radhitjen e dorëshkrimeve sipas fushave shkencore që iu përkasin.⁸ Sa i përket Hadithit, në këtë indeks janë përshkruar 29 dorëshkrime, të cilat do të t'i përmendim më vonë.

Përshkrimin e dorëshkrimeve e kanë bërë sipas mënyrës së mëposhtme:

- Emrin e autorit ose shumëzuesit
- Llojin e shkrimit
- Numrin e faqeve dhe të rreshtave brenda një faqeje
- Zakonisht e përmendin fillimin dhe mbarimin e dorëshkrimit
- Gjendjen e dorëshkrimit
- Njohuri të rëndësishme (referenca për personalitet e cekura)
- Shënime të rëndësishme
- Në pjesën përballë titullit të librit shkruajnë edhe inicialet e veçanta të librit sipas bibliografisë origjinale në Bibliotekën e Tiranës.

Ndonëse Instituti El-Furkan kishte ambicie që ta mbaronte projektin në tërësi, rrethanat e caktuara në Shqipëri e bënë të pamundur këtë gjë.⁹

Bibliografia e dorëshkrimeve në Bibliotekën Kombëtare në Tiranë dhe në Arkivin Shtetëror në Shqipëri¹⁰

Ndoshta i pari që ka trajtuar çështjen e titujve të dorëshkrimeve në Shqipëri është Gazmend Shpuza, i cili shkroi një artikull me titull: “*Dorëshkrimet Islame në Bibliotekën Kombëtare dhe në Arkivin Qendror të Shtetit në Shqipëri*”,¹¹ të cilin e publikoi në forumin shkencor të mbajtur në Prishtinë më 1992 nën patronatin e Bashkësisë Islame të Kosovës.

Në vitin 1997, revista *Perla*, publikoi një shkrim, të po këtij autori, në të cilën janë përmendur titujt e 178 dorëshkrimeve, për të shtuar në numrin tjetër të revistës edhe 211 tituj që gjenden në këtë bibliotekë. Autori përmend njohuri në shqip për dorëshkrimet, të cilat, në të shumtën e rasteve, janë të përmbledhura brenda një rreshti.

8 Librat e hadithit janë nga faqen 21 ndërsa numri rendor i arteve është 2.

9 Në këtë ka aluduar në parathënien e librit.

10 Revista në numrin e saj të I-rë dhe të II (1997), ka publikuar titujt e këtyre dorëshkrimeve në dy artikuj me titull: *Mahtutat arabijeh fi-l-mektebeti-l-vataniijeh fi Tirana*.

11 Gazmend Shpuza, “Dorëshkrimet Islame në Bibliotekën Kombëtare dhe në Arkivin Qendror të Shtetit në Shqipëri”, Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët” (Prishtinë, 1994), fq. 529. (Përmbledhje punimesh, konferencë ndërkombëtare organizuar nga Bashkësia Islame e Kosovës në Prishtinë.)

Përveç këtyre burimeve, nuk kam hasur në ndonjë burim tjetër që është marrë me këtë çështje. Kam shkuar në Shqipëri dhe e kam vizituar këtë Bibliotekë. Kam hulumtuar për dorëshkrimet. Biblioteka është në qendër të Tiranës, afër xhamisë kryesore. Ka libra të shumta dhe të fushave e shkencave të ndryshme. Radhitja është bërë rëndom sikurse edhe në bibliotekat e tjera.

Origjina e dorëshkrimeve me alfabet arab në Shqipëri

Gjatë hulumtimit nuk më ka rënë të gjej dikë të ketë shkruar diçka konkrete rreth kësaj çështje. Këtë pyetje ua kam parashtruar edhe hulumtuesve të ndryshëm në fushën e islamistikës. Kam konsultuar dhe shumë punonjës në fushën e Islamit që kanë jetuar deri në kohën tonë dhe të cilët kanë pasur lidhje aktive me jetën shkencore. Që të gjithë pothuajse janë dakord se me ardhjen e Islamit në këto troje është përhapur edhe libri Islam. Në këtë aludon dhe Profesor Mahmud Arnauti kur thotë: *“Rrëfimi për rrugëtimin e trashëgimisë arabe Islame në Shqipëri është i gjatë. Ka filluar me çlirimin osman të trojeve të Ballkanit në shek. IX h., ku qyteti shqiptar Shkodra, asokohe kryeqytet i Shqipërisë, ka qenë një qendër e rëndësishme shkencore, kulturore dhe letnare të merr përjetëzën, duke mos parë Shqipëria kurrë më parë një zhvillim të tillë. Duke qenë se gjuha arabe është gjuha me të cilën kuptohen parimet e fesë, atëherë depërtimi osman në Ballkan hap rrugën edhe për gjuhën arabe, e cila përjeton një përhapje të rrallë, veçmas në Shkodër. Kjo u mundësua falë thirrësve myslimanë të Perandorisë Osmane, pastaj shkollave të themeluara dhe ndërtuara nga osmanët. Natyrshëm, kjo ka ndikuar që trashëgimia Islame të bartet në Shqipëri, e cila tashmë ishte bërë një bazë e fortë e shkencave Islame. Stambolli, që ishte kryeqendër e Perandorisë, ishte vend prej nga më së shumti dërgoheshin dorëshkrime arabe, osmane dhe persiane. Pastaj, edhe vet kontributi i dijetarëve shqiptarë, të cilët shkruanin në gjuhën arabe, duke bërë kështu që kultura dhe trashëgimia Islame të lulëzojnë.”*¹²

Padyshim, sikur për gjithçka tjetër, edhe për këtë së pari i detyrohemi Allahut të Madhëruar, pastaj të gjithë atyre që na e sollën këtë fe të pastër. Kështu, u përhap feja e bashkë me të edhe dija dhe kultura.

Pra, siç mund të shihet, është gabim të thuhet se të gjitha dorëshkrimet janë të “importuara”, sepse dijetarët shqiptarë kanë lënë gjurmë të pashlyera dhe vepra origjinale, të cilat flasin për ata. Nga hulumtimi kemi kuptuar se ata ishin të zotët për sa i përket gjuhës arabe dhe se e kishin përvetësuar atë me mjeshtri të rrallë, duke e folur, lexuar dhe shkruar. Ndërsa sa i përket dorëshkruesve, kam gjetur se shumë prej tyre kanë qenë vendas.

12 el-Arnaut, *Mahruuat aslijeh fi Albanija*, fq. 8.

Periudha e fshehjes së librit islam

Kjo gjendje pati për pasojë fshehjen ose humbjen e librave, në mënyrë që dijetarët të mos i ekspozoheshin ndonjë akuze, apo të mos merreshin në pyetje. Disa i dorëzuan librat e tyre në biblioteka shtetërore, e gjithsesi edhe në Bibliotekën Kombëtare. Përgjegjësit thonë se kjo ka ndodhur në etapa të ndryshme. Mahmud Arnauti duke e deshifruar këtë periudhë thotë: “*Dorëshkrimet arabe, osmane dhe perse nga të gjitha anët e Shqipërisë janë transferuar në Bibliotekën Qendrore të Tiranës, duke filluar nga fillimi i vitit 1950, për të vazhduar me vite të tëra...*”¹³

Njerëzit i kanë dorëzuar në këto qendra për t’u shfajësuar, por në të njëjtën kohë kjo ka qenë një hap i duhur, pasi ato janë siguruar dhe ruajtur nga humbja, dëmtimi dhe shkatërrimi. Ka disa gjëra të dëmshme, por që në esencë kanë dobi.

Dorëshkrimet e Hadithit që gjenden në Bibliotekën Kombëtare në Tiranë

Dorëshkrimet që kanë të bëjnë me Hadithin në këtë Bibliotekë janë gjithsej 27 sosh. Në vazhdim, do t’i përmendi ashtu siç figurojnë në indeksin e dorëshkrimeve Islame në Bibliotekën Kombëtare në Tiranë.

NR.	EMRI I DORËSHKRIMIT
1.	<i>El-Ehadith el-kudsijeh</i> ¹⁴
Shifra:	An VIII/42 G
Autori:	Anonim
Shënime tjera:	Dorëshkrimi daton nga viti 1205 h. Faqet: 46. Lloji i shkrimit: kopje. Rreshtat në faqe: 11. Formati i kopertinës: 17x11cm. Formati i tekstit: 12x7 cm. Fillimi i dorëshkrimit: “ <i>Es-sahifetu el-ula: Jekul-Allabu tebareke ve teala azze ve xhel-le: axhibtu limen ejkane bil mevti kejfë jefrabu, ve axhibtu limen ejkane bil hasenati kejfë jexhmeul male...</i> ” Fundi i dorëshkrimit: “ <i>...ve eskentubu-n-nare ve: “inne hadba lefi-s-suhufi-l-ula, suhufi Ibrahim ve Musa</i> ” ¹⁵ Shënim: Autori ka përmbledhur hadithe kudsijje, të cilat i ka radhitur në 41 faqe.

13 el-Arnaut, *Mabrutat aslijeh fi Albanija*, fq. 8.

14 Nuk kam gjetur të dhëna për këtë libër.

15 El-A’la, 18-19.

2.	<i>El-ehadith el-meuduah</i> ¹⁶
Shifra:	An VIII/ 1 E
Autori:	Ebu el-Fedail el-Hasen ibn Muhammed es-Sagani el-Hanefijj
Shënime tjera:	Emri i kopjesit (shumëzuesit): Tahir ibn Kasim el-Ensari Viti i kopjimit: 771 h. Lloji i shkrimit: kopje. Faqet: 69. Numri i rreshtave në faqe: 17. Formati i kopertinës: 20x14 cm. Formati i tekstit: 14x7 cm. Fillimi i dorëshkrimit: “ <i>El-hamdulil-lahi Rabbil alemin ve-s-salatu ve-s-selamu el-ekmelani el-etemmani ala Sejjidina Muhammed ve Alihi ve Sabbibi el-berereti exhmein. Kale es-Sadru el-Imam el-Hibr Ebu-l-Fedail el-Hasen ibn Muhammed es-Sagani el-multexhi ila Haremi-l-Lahi, ed’halehu fi xbenabibi bi mezidi lutfihi ve ridvanihi, emma ba’du fekad kale Resulullahi –sal-laAllahu alejhi ve sel-lem-: “men kedbebe aleje muteammiden, fel-jetebeve mak’adehu mine-n-nar...”</i> ” ¹⁷ Fundi i dorëshkrimit: “ <i>...vehfedhna min ittibai-l-heva ve-d-dalaleti ve’hdina s-sir-ata-l-mustekim v-n-nehxe-l-kavim inneke Reufun Rahim.</i> ” Në përgjithësi, dorëshkrimi ka gjendje të mirë, edhe pse disa fleta janë lagur dhe lexohen me vështirësi.
3.	<i>Erbeune hadithen</i> ¹⁸
Shifra:	An I/48 B
Autori:	Muhammed ibn Ebi Bekr
Shënime tjera:	Emri i kopjesit: Sadik ibn Sulejman ibn Halil ibn Xha’fer Lloji i shkrimit: kopje. Numri i faqeve: 79. Numri i rreshtave në faqe: 13. Formati i kopertinës: 18.5 x 13. Formati i tekstit: 14x8. Fillimi i dorëshkrimit: “ <i>El-hamdu lil-Labi Rabbi el-alemin ve-l-akibetu li-l-mutte-kine ve la udvane il-la ala-dh-dhalimine, ve-s-salatu ala hajri halkihi Muhammedin ve Alihi et-tajjibine et-tahirine exhmein. Emma ba’du, fe innel-abde el-mudhnibe Muhammed ibn Ebi Bekr rahmetullahi alejhis ba’de tuli haudibi...</i> ” Fundi i dorëshkrimit: “ <i>...in vedeabu, tufe, ve in emsekebu, fehtereka. sadekAllahu ve sadaka Resulullahi fima kale. Temme-l-kitab bi aunil-Labi Teala.</i> ” Shënime: dorëshkrimi është në gjendje të mirë, është komplet megjithëse shkrimi është jo edhe aq i qartë.

16 Autori ka përmbledhur hadithet e shpifura ndaj Muhamedit a.s.. Libri është botuar nga *Dar El-Memnun li-t-turath* në Damask me korrekturën e bërë nga Nexhm AbduRrahman Halef.

17 Transmeton: Muhamed bin Ismail el-Buhari, *Sahih el-Buhari* (Bejrut: Dar ibën Kehtijr, 2002), vëll. 1 fq. 33 hadithi nr. 110. *Sahih Muslim* (Medine el-Muneverre: Daru Tajibe, 2006), vëll. 1 fq. 25 nr. 3. *Sunen Ibën Maxheb* (Damasku: Daru Ihjai kutub el-arabije, 2009), vëll. 5 fq. 8 nr. 2659.

18 Titulli nuk është në dorëshkrim, por kuptohet nga përmbajtja.

4.	<i>Esmau-rr-rruvat</i> ¹⁹
Shifra:	An I/8 F
Autori:	Anonim. ²⁰
Shënime tjera:	Lloji i shkrimit: kopje e mirë. Numri i faqeve: 9. Numri i rreshtave në faqe: 38. Formati i kopertinës: 31x21 cm. Formati i shkrimit: 27x19 cm. Fillimi i dorëshkrimit: “ <i>El-hamduli-l-Labiel-Ledhi arrefena hadithe-n-nebevijeti bi-abhari-s-sahabeti ve-t-tabiine, ve sherr-rrefena bi keshfi meaniba sherbu-sb-sharibine...ve xhealtuha ebvaben ala burufi-t-tehexb-xhi tejsiren li-t-talibine ve tarifen li-rr-rragibine, ve semmejtubu Esami-rr-rruvat. Bab El-Elif: Ubej ibn Ka'b...</i> ” Fundi i dorëshkrimit: “ <i>El-hamduli-l-Labi el-Ledhi jessere lena hatme-l-kita-bi bi-evsafi Hatimi-l-Enbija ve Sejjidi uli-l-elbab. Allahumme-hsburna meahu... bi-fadlike husne-l-bitab ve-rzukna shefaaten min tevessulina ilejhi bi-kelamih el-mustexhab. Temmet ve kemulet bi-avnih Teala ve busni teufikhi.</i> ” Gjendja: dorëshkrimi është në gjendje të mirë, edhe pse është i lagur pro nuk është dëmtuar.
5.	<i>El-xhamiu-s-sahib</i>
Shifra:	An VIII/7 B
Autori:	Ebu Abdullah Muhammed ibn Ismail el-Buhari
Shënime tjera:	Lloji i shkrimit: dorëshkrim. Vëllimi: vëllimi i dytë. Numri i faqeve: 236. Numri i rreshtave në faqe: 25 Formati i tekstit: 19x12 cm. Formati i kopertinës: 27x17 cm. Fillimi i dorëshkrimit: “ <i>Kitabu salati-t-teravib, bab fadlu men kame ramadane, haddethena Jahja ibn Bekir, haddetheni El-Lejth an Ukajlin an ibn Shibabin kale abbereni Ebu Seleme enne Eba Hurejrete kale...</i> ” Fundi i dorëshkrimit: “ <i>Ve jetlubu fi-l-muxhel-ledi eth-talithi gufatu Uhud, ve kavlu-Llahi: “Ve idh gadevte min belike...” Temme bi-hamdi-l-Labi ve mennibi ve lutfihi, ve-l-hamduli-l-Labi vahdehu ve salavatuhu ala hajri halkibi Muhammed, Resulih ve abdih, ve sel-lem teslimen kethiren.</i> ” Gjendja: e mirë.

19 Ekzemplar komplet i radhitur sipas alfabetit. Mbi tituj është vënë një vijë me ngjyrë të kuqe.

20 Nuk është aluduar në dorëshkrim askund për emrin e autorit.

6.	<i>El-xhamiu-s-sagîr min hadithi-l-Beshiri-n-Nedhir</i>
Shifra:	An V/10 E
Autori:	Xhelaluddin AbduRahman ibn Ebi Bekr Es-Sujuti
Shënime tjera:	Lloji i shkrimit: dorëshkrim. Numri i faqeve: 123. Numri i rreshtave në faqe: 19. Formati i tekstit: 17x10 cm. Format i kopertinës: 22x16 cm. Fillimi i dorëshkrimit: <i>“El-hamdu li-l-Lab el-Ledhi beathe ala re’si kul-li mieti senetin men juxheddidu li-hadhi-l-ummeti emre diniba ve ekame fi kul-li asrin me jehutu hadhi-bi-l-mil-lete...ve semmejtuhu El-Xhamiu es-sagîr min hadithi-l-Beshiri-n-Nedhir.”</i> Fundi i dorëshkrimit: <i>“Jedu’llabe bi hajr il-la istexhabeAllahu lebu ve la jesteidhu min shej’in il-la eadhehullahu minhu, an Ebi Hurejrete.”</i>
7.	Ekzemplar tjetër i kësaj vepre
Shifra	An VIII/16 A
Shënime tjera	Lloji i shkrimit: dorëshkrim. Numri i faqeve: 201. Numri i rreshtave në faqe: 35. Formati i tekstit: 21x12. Formati i kopertinës: 29x20. Fillimi i dorëshkrimit: <i>“El-hamdu li-l-Labi l-Ledhi beathe ala re’si kul-li mieti senetin men juxheddidu li-hadhi-l-ummeti emre diniba, ve ekame fi kul-li asrin men jehutu hadhi-l-mil-leti bi teshjidi erkaniba ve tejjidi suneniba.”</i> Fundi i dorëshkrimit: <i>“La juvafikuba abdun muslimun jed’ullabe bi-hajrin il-la istexhabeAllahu lebu, ve la jesteidhu min shej’in, il-la eadhehullahu minh, an Ebi Hurjrete. Temme el-kitab bi hamdi-l-Lab.”</i>
8.	Xhevahir el-erbeah
Autori:	Anonim
Shifra:	An IX/15 F
Shënime tjera:	Lloji i shkrimit: dorëshkrim Numri i faqeve: nga 59-66. Numri i rreshtave në faqe: 14. Formati i tekstit: 14x10. Formati i kopertinës: 20x14. Fillimi i dorëshkrimit: <i>“Kale en-Nebijju: Erbeatu xhevahir fi beni Adem tuziluba erbeate eshjae: emma el-xhevahir, fe-l-aklu ve-d-dinu ve-l-hajau ve-l-amelu-s-salihu.”</i> Fundi i dorëshkrimit: <i>“Sal-la et-teravîh mea-l-xhemati fekad mate shehiden, ve men tereke salate-t-teravîh meal xhemati hurr-rrime alejbi-l-xheneh ve hal-le lebu en-nar ve xheale mekambhu fi-n-nar, temme el-kitab.”</i> Gjendja e dorëshkrimit: Mirë.

9.	<i>Dekik el-abbar fi dhikri el-xhenneti ve-n-nar</i> ²¹
Autori:	AbduRrahim Ibn Ahmed
Shifa:	An VII/ 11 S
Shënime tjera:	Emri i shumëzuesit: Umer Fesh-shar Viti i dorëshkrimit: 1199 h. Lloji i shkrimit: dorëshkrim. Numri i faqeve: 113. Numri i rreshtave në faqe: 13. Formati i tekstit: 10x8 cm. Formati i kopertinës: 14x10 cm. Fillimi i dorëshkrimit: “ <i>Ve kad xbae fi-l-baber n-ne Alalh teala haleka shexhereten ve leha erbeatu agsanin fe semmaha shexheretul Jekin.</i> ” Fundi i dorëshkrimit: “ <i>Ehlul-Xhenneti j'kul v jeshreb thumme jesiru taamuhum ve sherabubum riban ke ribi-l-miski ve-l-kafur.</i> ” Gjendja e dorëshkrimit: e mirë.
10.	<i>Risaletun fi-l-firkati en-naxhijeti</i> ²²
Autori:	Anonim
Shifra:	An VII/20 D
Shënime tjera:	Lloji i shkrimit: dorëshkrim. Numri i faqeve: 55. Numri i rreshtave në faqe: 17. Formati i tekstit: 15x8. Formati i kopertinës: 22x15. Fillimi i dorëshkrimit: “ <i>Ve kile: el-haklu ala ashreti exhza, tisatun minha esh-shejatin ve-l-xhinn ve vahidun minha l-ins, thumme xbeale el-ins mieten ve hamsen ve ishrune sinfen.</i> ” Fundi i dorëshkrimit: “ <i>Ja Hajju ja Kajjum, la ilahe il-la Ente, subhaneke fekina adhabe-n-nar ve adhabe-l-kabri ve su-l-memati, sadeka.</i> ” Gjendja e dorëshkrimit: E mirë.

21 Në *Keshfu-db-dhunun* thuhet se Kadi AbduRrahimi është përkthyes i këtij libri ndërsa në Edh-dheriatu ve mu'xhmu al-matbuaat el-arabijeh thuhet se është autor. Libri fillon me përmbajtjen e librit. Shih: Haxhi Halijfe, *Keshfu-db-dhunun an esami el-kutub ve el-funun* (Bejrut: Dar Ihja et-turath el-arabi, 2008), f. 757; *Fehres al-mahmutat el-islamijeh bi-l-mektebeti-l-vatanijeh el-albanijeh fi Tirana*, fq. 27.

22 Titulli nuk është vendosur në dorëshkrim por është nxjerrë nga përmbajtja e librit.

11.	<i>Sherhu risaleti Usuli-l-hadith</i> ²³
Shifra:	An V/49 E
Autori:	Davud ibn Muhammed El-Karisi el-Hanefi err-Rrumi
Shënime tjera:	<p>Viti i përpilimit: 1151 h. Viti i dorëshkrimit: 1151 h. Emri i shumëzuesit: Husejn Abdul Baki Mufti Zadeh Lloji i shkrimit: dorëshkrim. Numri i faqeve: 32. Numri i rreshtave në faqe: 15. Formati i tekstit: 12x7 cm. Formati i kopertinës: 17x12 cm. Fillimi i dorëshkrimit: <i>“Elhamdu li-l-Lahi el-Ledbi eazze el-ulemae el-amiline ve-l-muhaddithine al-adiline ve refea el-hafidhine el-muttasiline ve-l-munkatiine, ve-s-salatu ve-s-selamu ala Sejjidi el-Enbija ve-l-Murseline ve ala alibi ve sa’bbibi exhmeine, ve ba’du: Fe jekulu al-abdu el-fekiru ila Alalhi el-Ganijji, Davud Ibn Muhammed el-Karisijj el-Hanefijj.”</i> Fundit i dorëshkrimit: <i>“Hadhi el-esami ve-l-musemmejat fessalnaba ilazeten li-hajretihim ve sadakaten xharijeten lehum ve ligajrihim. Elhamdu li-l-Lah el-Ledbi hedana li-hadha ve ma kunna li-nehtedije lev la en hedana Allah, fe-l-hamdu li-l-Lah ala el-hitam ve-s-salatu ve-s-selamu ala Resulina Muhammed alejbi-s-salatu ve-s-selam ve ala alibi el-idham ve as’habibi-l-kiram, ve kad feragtu min te’lifibi senete ihda ve hamsine ve miete ve elfi ashri rebii el-abar fi Misr. Allabumme-h-timna bi-l-imani bi hurmeti Sejjidi-l-enami. Temmet.”</i> Gjendja e dorëshkrimit: e mirë.</p>

23 Autori në këtë libër ka shpjeguar librin *Risaletun fi Usuli-l-Hadith* i autorit Muhammed Efendi el-Berkevi. Në te autori ka përmbledhur çështje bazë që kanë të bëjnë me Terminologjinë e Hadithit, të cilat i ka komentuar në version të shkurtuar. Gjatë hulumtimit në dorëshkrime kam gjetur disa ekzemplarë të këtij libri dhe nga intervistat me hoxhallarët nga gjeneratat e moshuara kam mësuar se libri ka qenë shumë i njohur dhe shumë i përdorshëm nga dijetarët, nxënësit dhe studiuesit e kohës. Është marr për bazë në planprogramet mësimore në të cilat është mësuar Terminologjia e Hadithit.

12.	<i>Sherhu Sahibi-l-Buhari</i> ²⁴
Autori:	Shihabuddin Ahmed ibn Muhammed ibn Ebi Bekr el-Kastalani el-Misriij esh-Shafijij
Shifra:	An I/6 A
Shënime tjera:	Viti i shkrimit: 910 h. Viti i dorëshkrimit: 1217 h. Lloji i shkrimit: dorëshkrim. Vëllimi: 3. Numri i faqeve: 545. Numri i rreshtave në faqe: 35. Formati i tekstit: 22x13 cm. Formati i kopertinës: 30x22 cm. Fillimi i dorëshkrimit: <i>“Kitab: el-Enbija salavatullabi alejhim exhmein. Bab: Dhikru halki Adem salavatullabi alejhi ve selamuhu v dhikru halki dburr-rrijetibi. Ve fi nus’hatin sahibatin kem afi-l-Juninijeh kitabu el-Enbij ve adeduhum.”</i> Fundi i dorëshkrimit: <i>“Ve jessere kemal hadhe-l-meuduë ve nefea bibi ve xbealehu halisan li-vexhibi-l-Kerim. Estevdiuhu Teala fi dhalike fe innehu el-Hafidhu el-Xhevadu l-Kerim err-rreuf err-rrahim, ve sal-laAllahu ala Sejjidina Muhammed en-Nebijj el-Ummijj ve alibi ve sabibi ve sel-lem.”</i> Gjendja e dorëshkrimit: e mirë, disa fjalë janë të shkruara me ngjyrë të kuqe.
13.	<i>Sherhu mesabihis-Sunneh</i> ²⁵
Autori:	Abd-l-Latif ibn Abdu-l-Aziz ibn Fersheteh Kermani
Shifra:	An VII/34 D
